

Kronikë nga mbledhja e 43-të e KR D

Shkup, 05.10.2012- Në mbledhjen e sotshme Këshilli për radiodifuzion (KR D) e rishikoi kërkesën e TRD Radio Kanal 77 nga Shtipi për ndërrimin e strukturës së pronësisë. Pasi ajo ishte konstatuar se radiodifuzeri ka dorëzuar dokumentacione të plota dhe se me ndryshimin e parashikuar nuk do të ketë shkelje të nenit 11 të ligjit për veprimtari radiodifuzive, dhe se nuk do të krijohet koncentrim mediatik i paligjshëm, KR D e miratoi ndryshimin e planifikuar në strukturën pronësore të TRD Radio Kanal 77. Me këtë është ndaluar edhe procedura për marrjen e lejes për të kryer veprimtari radiodifuzive të këtij radiodifuzeri.

Në lidhje me informatën për ndryshimin e kryer të pavarur të strukturës pronësore të TRD Hit Radio Dooel nga Strumica, KR D i shqiptoi këtij radiodifuzeri në afat prej tetë ditësh nga pranimi i letrës ti dorëzojë deklaratat e duhura, a në ndër kohë ta ktheje në gjendjen e mëparshme ndryshimin e realizuar në Regjistrin Qëndror.